



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL. Anr.208/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret; Kymete Kicaj - kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Partisë Social Demokrate (PSD) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 15.10.2025, merr këtë,

**V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.208/2025, e datës 13.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Partisë Social Demokrate (PSD) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

**A r s y e t i m**

Me datën 14.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.208/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 12.10.2025, në orën 12:31, është vërejtur se kandidatja për asamble në Komunën e Prishtinës nga radhët e Partisë Social Demokrate, znj. Anita Shabani Cacaj, përmes kanalit të saj në rrjete sociale, ka publikuar, dhe sponsorizuar për më shumë visibilitet, një material me përmbajtje qartësisht propaganduese, ndonëse periudha e heshtjes zgjedhore ka hyrë në fuqi, i cili veprim përbën shkelje të rregullave zgjedhore, përkatësisht nenit 37 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, që ndalon çdo aktivitet fushate gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 5, të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, i cili ndalon shfrytëzimin e rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik Partia Social Demokrate theksohet se sipas provave të bashkëlidhura me ankesën e parashtruar, nga fotografia në cilësi të provës nuk figuron data se kur është nxjerrë fotoja si dëshmi mbështetëse e ankesës. Ajo që shihet në fotografinë e deponuar është vetëm ora e cila rezulton të jetë 12:31, por nuk figuron askund data e publikimit. Video në formë të fotos për të cilën pala ankuese ka bërë ankesë nuk është publikuar në ditën e

heshtjes zgjedhore, dhe se publikimi është bërë me datë 09.10.2025 në ora 19:42, në faqen time të <https://www.facebook.com/anita.shabani/>. Andaj as nga pretendimi i ankesës dhe as nga provat e parashtruara nuk mund të vërtetohet koha e shkeljes së supozuar, dhe faktet e bashkangjitura në këtë ankesë dëshmojnë që publikimi dhe sponsorizimi kanë ndodhur në periudhën që nuk përfshin ditën e heshtjes zgjedhore. Po ashtu fotografia e deponuar në cilësi të provës nuk është provë e mjaftueshme për të provuar pretendimin në ankesë, marrë parasysh se e njëjta nuk tregon datën, theksohet në përgjigje në ankesë.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PSD, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, lidhur me shkeljen e pretenduar se kandidatja për asamblë në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik PSD, znj. Anita Shabani Cacaj, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesën e tyre kanë bashkangjitur postimin e kandidatës në fjalë, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet se e njëjta postimin e ka bërë gjatë ditës së votimit, pasi që nga provat e parashtruar dhe hetimit të bërë nga Paneli është vërtetuar se postimi i kandidatës në fjalë është bërë me datë 09.10.2025, në ora 19:42 minuta, dhe se dita e votimit është mbajtur me date 12 Tetor 2025, e që sipas vlerësimit të Panelit nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përmendura më lartë. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, në ndërkohë që me provat tjera është vërtetuar se ky postim ka ndodhur para hapjes së Qendrave të Votimit. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par. 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

ZL.Anr.208/2025, datë 15.10.2025

Kryesues i Panelit,  
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.